



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

MIRATOHET

PJERIN NDREU

KRYETAR

# DETÝRË PROJEKTIMI

**PËR REALIZIMIN E STUDIM PROJEKTIMIT:  
“RIKONSTRUKSION URE ME HD = 6m , NE RRUGEN QAFE PAZARI –  
VOME, FSHATI RASE –BUT ,  
NJESIA ADMINISTRATIVE UNGREJ ,  
BASHKIA LEZHE .**

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT DHE ZHVILLIMIT URBAN .**

HARTOI

Pergjegjesi: Ing. Gjyste Dushku

MIRATOHET

Ark. Entela Ndoj

DREJTORI

Ing. Bardhok Brunga

FLAMUR KUÇI

Lezhë Shtator 2024

## **HYRJE**

### **Institucioni përfitues**

Institucioni përfitues i shërbimit në fushën e projektimit është Bashkia Lezhë. Përfituesi i këtij shërbimi është Institucion Publik.

Misioni i këtij institucioni është të sigurojë një infrastrukturë sa më cilësore për popullatën ,banoret etj.

Përfituesi i projektit është komuniteti njesis vendore perkatese , kalimtare te ndyshem , etj. për infrastrukturën fizike të të cilit është pergjegjës pushteti vendor.

### **Arsyetimi i nevojës për ndërhyrje.**

Problematika që sjell nevojën e investimit. Në rast se nuk ka problematikë por përputhet me strategjinë e zhvillimit shtjellohet strategjia që e bën të nevojshëm investimin.

Ky projekt është nevojë e rëndësishme e momentit e institucionit për realizimin e veprimtarisë së tij institucionale, si dhe përputhet me strategjinë e zhvillimit të Bashkisë Lezhë dhe orientimeve të ministrisë së linjës.

### **Baza ligjore.**

Bazuar në statusin ligjor të institucionit, ky shërbim në fushën e projektimit duhet të përmbushtë kërkesat dhe të marrë në konsideratë referencat si vijon:

- Ligj Nr. 139/2015 “Për veteqeverisjen vendore”
- Ligj Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i përditësuar
- Rregulloren e Zhvillimit të Territorit (në fuqi).
- VKM Nr.1503, datë 19.11.2008 “Për miratimin e Rregullores “Për shfrytëzimin e hapsirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar””.
- Çdo ligj, apo manual tjetër, të lidhur me projektimin e strukturave të kësaj natyre.

### **Qëllimi i projektit të investimit.**

Qëllimi i rikonstrukzionit është që të përmirësohet infrastruktura rrugore , kalimi i ‘Perroit te Vomes ’ i banoreve dhe mjeteve automobilistike te zonave te banuara ne zonen e fshatit RASE – BUTE, Njesia Administrative Ungrej, Bashkia LEZHE.

### **Objektivat e projektit të investimit.**

Objektivi kryesor i këtij projekti është të sigurojë kumunikimin e banoreve te zones dhe i mjeteve te transportit si dhe makinerive bujqesore , si një ceshtje e mprehte sociale per punësimit dhe mirëqenie.

## **PËRSHKRIM I DETYRËS SË PROJEKTIMIT**

### **Qëllimi**

Detyra e Projektimit ka për qëllim parashtrimin e të dhënavë thelbësore, njohëse, kërkesave dhe nevojave specifike të institucionit përfitues, në cilësinë e Porositësit, kundrejt shërbimit të kërkuar, si dhe orientimet mbi problematikën aktuale të shtruar për zgjidhje, mbi bazën e të

cilave, grupi i projektimit, do të hartojë projektin për “Rikonstruksion ure me  $hd = 6m$ ”, ne rrugen Qafe Pazari –Vome , fshati Rase –Bute , Njesia Administrative Ungrej

## Objektivat

Detyra e projektimit ka këto objektiva:

- Të prezantojë grupin e projektimit me vendndodhjen, infrastrukturën dhe problematikën e gjendjes faktike të struktures që i nënshtronhet ndërhyrjes.
- Të përshkruajë kërkosat sasiore dhe cilësore kundrejt shërbimit të porositur.
- Të evidentojë kërkosat profesionale kundrejt grupeve të projektimit.
- Të shtjellojë formën, mënyrën dhe afatet e raportimit të materialeve pranë Porositësit.


## Përshkrim i përgjithshëm.

### Pozicionimi i parcelës që zhvillohet.

**Vendndodhja:** Struktura ne te cilen do te nderhyet , gjendet ne fshatin RASE –BUTE , Njësia Administrative UNGREJ , Bashkia Lezhe

Koordinatat e struktures: 41.896005, 19.787514





*Pozicionimi i struktura lidhur me qendrën e qytetit të Lezhës*

## I. PERSHKRIMI I SHKURTER I GJENDJES

### 1. "RIKONSTRUKSION URE ME HD = 6m NE RRUGEN QAFE PAZARI –VOME , FSHATI RASE –BUTE , NJESIA ADMINISTRATIVE UNGREJ , BASHKIA LEZHE .

Emertimi: "Rikonstruksion ure mbi Perroin e Vomes , per te mundesuar kalimin e mjeteve dhe banoreve te zones dhe ben te mundur lidhjen e dy zonave te te njejtit fshat RASE –BUTE si dhe te banoreve te tjere ne zonen perreth

Kjo ure ka nje hapesire drite 6 m dhe gjeresi 4.6 m .

Ura nuk eshte e demtuar ne strukturen mbajtese . Shpatullat e ures ne te dyja anet e saj jane ne gjendje te mire teknike . Dyshemeja e ures eshte e ndertuar nga 4 soleta b/a me gjeresi 1.2 m secila . Te kater soletat kane krijuar probleme , jane amortizuar e demtuar shtresat e betonit duke bere qe hekurat e soletave te dalin jashte ne siperfaqe , Gjithashtu eshte demtuar komplet shtresa e betonit mbi ure dhe bordurat e betonit ne te dyja anet , prandaj ka nevoje per nderhyrje .

Ne te dy anet e ures mungojne tabelat informuese qe percaktojne se deri ne sa ton mund te mbaje kjo ure.





### ***Kërkesat teknike planimetriko – kompozicionale dhe infrastrukturore***

Projektuesi duhet të kryejë të gjithë punën në përputhje me standardet e projektimit dhe ndërtimit që janë në fuqi në Shqipëri.

Gjatë hartimit të meren parasysh kondicionet e PPV Bashkise Lezhe. Projektuesi duhet të marrë në konsideratë legjislacionin në fuqi për ndërtimet, kryesisht: Ligji 107/2014 Për planifikimin e zhvillimit te territorit i ndryshuar; Ligji nr 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” te ndryshuar; etj.

Hartimi i projekteve specifikë, të shtjelluar në vijim, duhet të mbështetet në studimet e thelluara të gjendjes faktike. Çdo dokument teknik që disponohet nga institucioni në shërbim të procesit të projektimit do t'i vendoset në dispozicion grupit të projektimit..

Gjithashtu grapi i projektimit do të duhet të bëjë një rilevim faktik arkitektoniko-konstruktiv të struktureve .

Grapi i projektimit do të duhet të bëjë percaktimin e sakte te nderhyrjes ne mbrojtjen e ures ne te gjithe gjatesine e saj.

Për objektet e përshfira në këtë shërbim konsulenti duhet të hartojet:

### **1 Raport Studimor Paraprak**

Në këtë raport studimor Konsulenti duhet të studiojë shkallen e demtimit emergjent, ne te gjithe gjatesine. Ky raport duhet të përmbarjë:

**1.1 Inspektim vizual dhe përshkrim i gjendjes aktuale të demtimit te ures.**

Përshkrimi duhet të përmbajë relacion shpjegues mbi mënyrën e nderhyrjes ne pjesen e demtuar nga pikepamja tekniko-inxhinierike.

## 1.2 Metodologjia e ndërtimit

Konsulenti duhet të përshkruajë mënyrën se si do të perforcohet zona e demtuar nga pikpamja teknike, llogjistike dhe programore, perqatitjet e materialeve dhe transportin gjate zbatimit.

## 1.3 Panimetri

Konsulenti duhet të hartoje një planimetri në harta të shkallës Sh:1: 25000 , 1:10000, si dhe ne shkallen 1:100; 1:200 dhe 1:500 qe tregon:

- i) Emertimin e skemes dhe Bashkine perkatese.
- ii) Zonen ku behet rehabilitimi i vepres, rruget, fshatrat, etj
- iii) Legjenden.
- iv) Planimetria do te perpunohet edhe ne versionin AUTOCAD

## 1.5 Relacion teknik

Ky relacion do të trajtojë çështjet teknike që lidhen me uren dhe masa e zgjidhje teknike për përmirësim apo modernizim të tyre. Relacioni do të përmbajë:

- i) Gjendjen ekzistuese te ures
- ii) Gjatesine e gjeresine e ures .
- iii) Punimet ne keto vepra .

Për hartimin e Raportit Paraprak, Konsulenti duhet të studiojë dhe të marrë në konsideratë çdo projekt apo studim të mëparshëm që ndodhet në Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit, Bashkine Lezhe apo burim zyrtar tjetër.

### Kërkesa të përgjithshme.

Gjatë hartimit të projektit do të mbahet kontakt i vazhdueshëm me autoritetet e Institucionit dhe grupin e punës së përpilimit të detyrës së projektimit, i cili do të vendosë në dispozicion të grupit të punës për hartimin e projektit një fotokopje të dokumentacionit tekniko – juridik që disponon, në shërbim të procesit të projektimit;

Autorët e projekteve duhet të marrin përsipër përvèç realizimit të planeve dhe skicave (vizatimet teknike) të përshkruajnë në mënyrë të detajuar të gjitha zërat e punimeve që do të përmbajë preventivi;

Projekti të shoqërohet me një relacion teknik ku të përshkruhen saktë zgjidhjet e ofruara teknike, avantazhet dhe prioritetet e tyre, materialet dhe paisjet e përdorura, vetitë dhe karakteristikat e tyre;

Gjithashtu, grapi i projektimit duhet të marrë përsipër konsultat me zbatuesin si dhe predispozicionin për tu angazhuar në ndryshimet e mundëshme që mund të lindin, si pasojë e situatave të paparashikuara apo shmangjive si evoluim i kërkesave të investitorit në procesin e realizimit;

Projekti duhet të perfshije dhe specifikimet teknike për materialet që do përdoren, por projektuesi duhet të ketë kujdes të mos përcaktojë markën apo çdo detaj tjetër që identifikon prodhuesin;

Në përgatitjen e projekt–preventivit të merret në konsideratë funksionimi, komoditeti dhe estetika e ambienteve të tij. Gjithashtu, preventivat e punimeve të jenë të ndara me grupe zérash pune, spas ambienteve që të mund të kryhen në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri.

### **Kërkesa të vecanta.**

Zgjidhjet dhe ndërhyrjet e propozuara duhet të bazohen në kritere të tilla:

Të kenë ndikim minimal në mjedis.

Të jenë propozuar në përputhje me funksionin e structures.

Çdo ndërhyrje të jetë e mirëjustifikuar nga pikëpamja teknike dhe funksionale.

Ky raport do të dorëzohet 15 ditë pas datës së fillimit të kryerjes së shërbimit.

### **Shërbimet e kërkuaara sipas fazave.**

Grupi i projektimit duhet të kryejë shërbimet e mëposhtme:

#### **Hartimin i projekt preventivit duhet të përfshijë fazat si vijon:**

Kosto totale do të përcaktohet nga preventivi përfundimtar i objektit, që do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimeve teknike, relacionin, si dhe duke marrë parasysh dhe kërkosat e vecanta të Bashkisë në lidhje me standartet e pranuara.

Në hartimin e preventivit çmimet e referencës do të jenë sipas legjisacionit, mbështetur në Manualin Teknik të Çmimeve në fuqi, **ne sistemin e integruar ne e –albania**. Për zërat e punimeve që nuk gjenden në manual, projektuesi duhet të hartoje analiza përkatëse, të cilat do ti bashkëlidhen të detajuara projekt zbatimit, kjo për të siguruar kursimin dhe eficencën e përdorimit të fondeve.

Faza I - Analiza e detyrës së projektimit / përcaktimi i bazës së projektit.

Faza III - Projektideja përfundimtare.

Faza IV - Projekt i përmiratimin e lejes së ndërtimit.

Faza V - Projekt i zbatimit.

Faza VI - Preventivi përfundimtar bazuar ne Manualin Teknik të Çmimeve në fuqi, ne sistemin e integruar ne ‘e –albania’ .

## **Standarde në Projektim**

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbljnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga Projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.

### **Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik**

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e këruara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihen parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për planifikimin e territorit” I ndryshuar .

## **Realizimi i Projektit**

Projekti i paraqitur për strukturen “RIKONSTRUKSION URE ME HD = 6m NE RRUGEN QAFE  
PAZARI –VOME , FSHATI RASE –BUTE ,  
NJESIA ADMINISTRATIVE UNGREJ ,  
BASHKIA LEZHE .

, duke iu referuar VKM Nr. 354, datë 11.5.2016 “Për Miratimin e manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikëqyrje Dhe Kolaudim” duhet të kalojë në këto faza:

### **Faza e I:                   Analiza e detyrës së projektimit e cila përfshin:**

Shërbimet bazë:

- Qartësimi i kërkesave të detyrës së projektimit.
- Dhënia e konsultave mbi nevojën edhe shkallët e shërbimit.
- Përbledhja e rezultateve

Shërbimet të veçanta

- Studimi i gjendjes
- Analiza e vendodhjes
- Planifikimi i punës
- Verifikimi i rëndësisë së mjesidisit
- Verifikimi i pajtueshmërisë me mjesidin

### **Faza e II :                   Projekt-ideja përfundimtare (sistemet dhe planifikimi i integruar)**

Projekt Idea duhet të realizohet në jo më pak se një variant, ku për secilin variant duhet të paraqitet relaciuni teknik mbi ndërhyrjet, projekt i ndërhyrjeve, kostoja e ndërtimit për secilin variant dhe specifikimet teknike. Paraqitura e varianteve duhet të bëhet në bazë të ndërhyrjes, të rezultateve të vlerësimit të kostos së ndërtimit dhe asaj të shfrytëzimit.

Varianti me treguesit më social - ekonomik dhe teknik që do përzgjidhet , do vazhdoj procedurën e hartimit të projekt zbatimi.

**Faza e III :** *Projekti për miratimin e lejës së ifrastrukturës.*

Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së infrastruktureve, i cili duhet të mbështetet në ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” I ndryshuar .(nese kerkohet sipas ligjit)

**Faza e IV:** *Projekti i Zbatimit*

Të kryhet hartimi i Projekt - Zbatimit të objektit ‘me përbajtjen si më poshtë :

- Raporti Teknik
- Rilevimi

Konsulenti duhet të hartoje relevimin e zones ku eshte vendosur struktura ne pikat nevralgjike te saj .

## **2.2 Projekt Zbatimi**

Konsulenti do të hartoje projektin e zbatimit për uren . Rehabilitimi do të konsistojë në ruajten e zgjidhjeve teknike të projektit fillestar dhe ndryshime, në varësi të kushteve aktuale ku ndodhet skema.

## **2.3 Volumet dhe Preventivi**

Konsulenti do të hartoje volumet paraprake për të gjitha kategoritë e punimeve të projektit. Volumet do të llogariten mbi bazë të vizatimeve të projektit. Çmimet njesi për të gjitha punimet do të llogariten duke patur si referencë çmimet e miratuara me manualet në fuqi (*Preventivi me cmimet e sistemit te integruar te cmimeve VKM nr.216, Dt. 13.04.2023*).

### **Rekomandime për projektuesin**

- Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me zonën ku ndodhet ura .
- Projektuesi duhet të përdore studimet dhe të dhënët paraprake që disponohen nga Bashkia e Lezhe , seksioni i Urbanistikës dhe nga kadastra.
- Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standardin e kërkuar.

Gjithashtu projektuesi duhet të paraqesë

- Plani i vendosjes së strukturës në shkallën 1 : 1000 format A3 , i cili do të hartojet në bashkëpunim me Drejtoren e Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë së Lezhe.
  - Rilevim topografik .
  - Licencë të shoqërisë projektuese + ekstrakt të Regjistrat Tregtar
  - Licenca të inxhinierëve projektues, licenca të ekspertit mjedisor + deklarata notieriale të inxhinierëve projektues.
  - Plan -Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar
- Projekti do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë e Lezhës . Stafi që kërkohet duhet të mbulojë :
- Inxhinier ndërtimi strukturist (konstruktor).
  - Inxhiner gjeodet.
  - Inxhinier hidroteknik/hidraulik.

- Preventivues.
- Staf mbështetës përfushat e mësipërme.

## Raportimi

Raportet dhe dokumentat duhet të jenë në 5 (pesë) kopje, në gjuhën shqipe ku njëra nga kopjet të jetë e printuar me ngjyra. Vizatimet duhet të jenë të lexueshme në formatin “dëg” (AutoCad 2007-2012). Të gjitha materialet do të dorëzohen edhe në soft-copy (në 5 CD).

Relacioni teknik që shoqëron projektin duhet të përmbajë:

- Raportin teknik të projektimit konstruktiv ku duhet të përfshihet edhe rapporti mbi llogaritjet për strukturat
- Specifikimet Teknikë të cilat duhet të jepen për çdo zë pune.
- Rekomandime dhe propozime për raste të veçanta.
- Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis (nese e kerkon ligji)
- Raport teknik; Preventiv; Rilevimi.
- Grafiku i punimeve.
- Licensat e stafit projektues.
- Deklaratat e pergjegjesis profesionale te stafit pjesmarres ne hartimin e projektit.Dorëzimi final, fizik, i projektit të zbatimit,

### **Investimi Themelor**

Investimi themelor do të dal nga varianti më i mirë tekniko-ekonomik i aprovuar nga Bashkia Lezhe.

### **Sqarime të fundit**

Në hartimin e Raportit Studimor Paraprak dhe projektit të zbatimit do të shfrytëzohet edhe arkiva e teknike e Drejtore se Ujitjes dhe Kullimit dhe e Bashkise Lezhe . Për këtë qëllim, firma konsulente e interesuar, përpëra se të dorëzojë ofertën e saj, duhet të marrë kontakte me Drejtoren e Ujitjes dhe Kullimit dhe e Bashkise Lezhe dhe institucionet e tjera në lidhje me disponibilitetin e materialeve që do ti nevojiten.

### **Marrja në dorëzim**

Marrja në dorëzim e dokumentacionit të shërbimit (raporte, projekte etj.) do të bëhet nga grup me specialistë të Bashkise Lezhe .